



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2020, ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane për projektin “Bashki të forta”” (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Bujar Çela, Fatjona Dhimitri, Erion Piciri, Amra Barova, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Jeton Xoxa – përfaqësues nga Drejtoria e Integritimit në Ministrinë e Brendshme.

HAPET MBLEDHJA

Ramazan Gjuzi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Fillimisht, do të bëjmë prezencën e anëtarëve të komisionit.

Zonja Kumbaro, prezent.

Zoti Ylli, prezent.

Zoti Ulqini, prezent.

Zonja Bello, prezent.

Zoti Beqiraj, prezent.

Zoti Nasufi, prezent.

Zonja Rista, prezent.

Zoti Çela, prezent.

Zonja Xhembulla, prezent.

Zonja Nikolla, prezent.

Zonja Kapllani?

Zonja Dhimitri, prezent.

Zoti Qamo, prezent.

Zoti Papa, prezent.

Zoti Jenisheri, prezent.

Zonja Borova, prezent.

Zoti Piciri, prezent.

Kuorumi është i plotësuar.

Fillojmë mbledhjen.

Siç jeni njoftuar nga sekretaria, sot në rendin e ditës kemi diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zviceriane për projektin “Bashki të forta””. Komisioni ynë në këtë projektligj është komision për dhënie mendimi.

Të ftuar kemi zotin Jeton Xoxa nga Drejtoria e Integritimit në Ministrinë e Brendshme.

Përshëndetje, zoti Xoxa!

Mund ta hapni mikrofonin, ju lutem?

Jeton Xoxa – Përshëndetje, zoti kryetar!

Ramazan Gjuzi – Zoti Xoxa, mirë se keni ardhur!

Fjala për ju, shkurtimisht.

Jeton Xoxa – Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane për projektin “Bashki të forta” ka si qëllim të përgjithshëm ofrimin e shërbimeve të përmirësuara për menaxhimin e mbetjeve dhe për arsimin parashkollor në nivelin bashkiak, nëpërmjet një projekti të financuar nga qeveria zvicerane, me një buxhet maksimal prej 12,8 milionë franga zvicerane.

Objektivat kryesore të projektit janë:

-krijimi i statistikave zyrtare të nivelit vendor, me qëllim që pushteti qendror dhe vendor të përdorin të dhënat zyrtare vendore dhe sistemin statistikor, në nivelin vendor, për përmirësimin e shërbimeve;

-krijimi i një administrate lokale performuese, transparente, me qëllim që administratat e bashkive të kryejnë funksionet e tyre për përmirësimin e kryerjes së shërbimeve, si dhe nxitja e përfshirjes së qytetarëve;

-krijimi i këshillave bashkiakë të fortë, me qëllim forcimin e përfaqësimit dhe funksioneve të mbikëqyrjes së tyre.

Projekti i financuar nga pala zvicerane do të krijojë mundësinë e krijimit të një regjistri të statistikave në nivel vendor, duke mundësuar një ndërveprim më të mirë ndërmjet pushtetit qendror dhe pushtetit vendor për sa u përket aspekteve të politikave vendore, si pasojë e reformës territoriale. Duke qenë se strukturat e bashkive janë më të mëdha, kanë nevojë për të dhëna statistikore, në mënyrë që të aplikojnë për financime vendase dhe të huaja.

Një nga synimet kryesore të këtij projekti është krijimi i regjistrave statistikore vendorë.

Disa nga efektet e pritshme të projektit janë mbështetja për të ndërtuar një sistem statistikor vendor në bazë të regjistrit të INSTAT-it. Ky sistem do të jetë kontribut kryesor për qeverinë shqiptare dhe për implementuesit e tjerë të INSTAT-it.

Gjithashtu, një nga synimet është përmirësimi i disa shërbimeve, si menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor, të cilat janë funksione kryesore të bashkive, që do të jenë në fokusin e këtij projekti.

Për shërbimin e arsimit parashkollor do të zhvillohet një model për menaxhimin në nivel bashkiak në bazë të bashkive, të cilat përfaqësojnë 6 tipologji urbane, rurale në Veri, në qendër dhe në Jug, të përcaktuara në fazën paraprake së bashku me ministrinë e linjës.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Xoxa!

Fjala për relatorin, zotin Nasufi.

Fadil Nasufi – Faleminderit, kryetar!

Së pari, dua të shpreh mirënjohje dhe falënderime për qeverinë e Konfederatës Zviceriane, që është një nga vendet kryesore donatore për Shqipërinë dhe një partner shumë i besuar dhe prioritar për sa i përket bashkëpunimit për zhvillim, ku përfshihen gati 30 marrëveshje të përbashkëta në fushën e tregtisë, të ekonomisë, të energjisë, të bujqësisë, të mjedisit, të arsimit e të tjera!

Në këtë kuadër, si ish-kryetar i Bashkisë së Beratit, kam pasur tri projekte me qeverinë zviceriane, të realizuara nga aseti për ngritjen e një qendre të personave me aftësi të kufizuara, për financimin e projektit për arsimin profesional nga *Swiss Contact*-i dhe për mbylljen e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe ndërtimin e një landfilli të ri, i cili po implementohet aktualisht.

Marrëveshja që po miratojmë sot për projektin “Bashki të forta” është pjesë e strategjisë së bashkëpunimit të Zvicrës për Shqipërinë gjatë periudhës 2017-2022.

Siç e sqaron relacioni i paraqitur nga Këshilli i Ministrave dhe sqarimet që dha zoti Xoxa, ky projektligj është në përputhje me legjislacionin shqiptar; është nënshkruar më 11 maj 2007 dhe është ratifikuar në parlament në vitin 2007.

Qëllimi i projektit u prezantua nga përfaqësuesi i Ministrisë së Brendshme. Në fokus janë tre objektiva kryesore: krijimi i statistikave zyrtare në nivel vendor, me qëllim që pushteti qendror dhe ai vendor të kenë burime të sakta statistikore; krijimi i një administrate lokale performuese dhe transparente, që të rrisin cilësinë e shërbimeve, që të rritet efienca e funksioneve me qeverisjen vendore dhe të përfshihen qytetarët në bashkëqeverisjen vendore; të trajnohen dhe të rritet pesha e këshillave bashkiake, ku është i rëndësishëm roli i përfaqësuesve të tyre në komitet, roli mbikëqyrës i funksioneve që kryejnë bashkitë dhe të qenurit dobiprurës për banorët dhe territorin, ku bashkitë ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Për sa i përket rrisë së këtij projekti, ne dimë që kemi realizuar reformën e administrativo-territoriale në vitin 2015, ku nga 373 njësi vendore sot kemi 61 të tilla. Ulja e numrit të njësive

vendore dhe ristrukturimi drastik i tyre kërkon edhe trajnime dhe financime për funksionet e reja që kanë njësitë vendore.

Si deputetë jemi në dijeni për ligjin e ri të qeverisjes vendore nr.139/2015, për ligjin e financave vendore dhe për një sërë aktesh të tjera të ndërmarra, që kanë të bëjnë me demokratizimin e qeverisjes vendore, me rritjen e autonomisë dhe decentralizimin, me performimin e qeverisjes dhe përafrimin e saj me qytetarët, me fuqizimin e kompetencave dhe rolin në rritje të bashkive. Janë përcaktuar qartë burimet e financimit dhe të ardhurat bashkiake, janë transferuar një sërë funksionesh dhe kompetencash për arsimin parashkollor, për shërbimet sociale, për bujqësinë, për pyjet, për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri e të tjera dhe janë krijuar hapësira përmes decentralizimit fiskal për shfrytëzimin e resurseve që ka çdo bashki në territorin e Shqipërisë.

Dua të sjell në vëmendje faktin që qeveria “Rama” i ka dyfishuar transfertat e pakushtëzuara pas vitit 2015 dhe financimet për qeverisjen vendore sot zënë gati 1% të GDP-së.

Pa u ndalur më tej, është e nevojshme ngritja e zyrave dhe statistikave vendore, sepse trashëgimia e deritanishme tregon që pak bashki i kanë burimet statistikore në nivelin vendor. Rritja e bashkive në numër dhe zgjerimi i tyre në territor mundëson ngritjen e këtyre zyrave. Këtu kam një pyetje për zotin Xoxa. Zyrat, struktura apo logjistika për çdo bashki do të jenë detyrim i bashkive apo pjesë e financimit të këtij projekti, sepse gjithmonë miratohen funksione shtesë për shërbimin social, apo për raportet gjinore si detyrim ligjor, por kur vjen puna te ngritja e zyrës funksionale këto mungojnë në bashki?!

Për sa i përket projektit “Bashki të forta”, synohet forcimi i qeverisjes vendore nëpërmjet trajnimit të administratës dhe këshillave bashkiakë. E gjithë asistenca konsiston në mbështetjen e reformës dhe të sfidave që ka qeverisja si një ndërhyrje afatgjatë në forcimin e bashkive, pas ristrukturimit të tyre. Në thelb kërkohet të kapërcehet ngërçi midis qytetarëve dhe administratës, të rritet shumë transparenca, llogaridhënia, mbikëqyrja, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, buxhetimi me pjesëmarrje dhe fuqizimi i besimit reciprok të qytetarit me pushtetin vendor.

Një komponent i rëndësishëm i projektit është përmirësimi i dy shërbimeve: menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor. Do të përcaktohen katër zona për trajtimin e mbetjeve dhe deri në 30 bashki që do mbështeten drejtpërdrejt për përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel bashkiak. Për arsimin parashkollor do të përzgjidhen gjashtë bashki: dy në Veri,

dy në qendër të Shqipërisë dhe dy në Jug, me tipologjitë përkatëse, duke përfshirë komponentët më të spikatur si projekte pilot.

Projekti “Bashki të forta” shtrihet në kohë nga 1 korrik 2017-30 shtator 2022. Këtu kam një pyetje tjetër. Çfarë është bërë konkretisht me këtë projekt nga viti 2017 deri tani në vitin 2020 dhe çfarë ngelet për t’u bërë deri në vitin 2022?

Qeveria shqiptare ka pagesën prej 1,1 milionë frangash për TVSH-në, e cila do të lëvrohet nëpërmjet Ministrisë së Brendshme. Marrëveshja është firmosur nga ministri i Brendshëm dhe ambasadori i Zvicrës, ku janë përcaktuar qartë detyrimet, përgjegjësitë, menaxhimi, mbikëqyrja, monitorimi, prokurimi, aktorët përgjegjës dhe çdo detaj që e bën atë të implementueshme, ndaj ju ftoj që ta votojmë edhe ne, pasi e ka votuar edhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese dhe ai i Integritimit.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Kush nga deputetët e do fjalën?

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Nuk ka gjë, sepse më duket se e kërkon fjalën zonja Dhimitri.

Fatjona Dhimitri – Vazhdoni ju, sepse edhe unë një koment kam.

Ramazan Gjuzi – Vazhdoni, zonja Dhimitri.

Fatjona Dhimitri – Dakord. Faleminderit!

Kam një pyetje për zotin Xoxa lidhur me marrëveshjen.

Nga sa lexova në relacion, kuptova që marrëveshja, bazuar në strukturën dhe ndarjen administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë, ka marrë parasysh prefekturat dhe bashkitë. Si qëndron kjo marrëveshje në raport me ligjin “Për rajonet dhe kohezionin social”?

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zonja Dhimitri!

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Duke pritur nga zoti Xoxa përgjigjet për pyetjet që bënë kolegët e mësipërm, doja të sillja një shembull. Në dijeninë time në projektin “Bashki të forta” kanë marrë pjesë në formën e një konkursi të hapur disa bashki nga qarku i Gjirokastrës, ndaj doja të ndaja me ju përvojën e bashkisë së Përmetit. Kam kënaqësinë të ndaj me ju faktin që bashkia e Përmetit është fituese, ndoshta edhe midis bashkive të tjera, në projektin “Bashki të forta” dhe falë kësaj përzgjedhjeje Këshilli i Bashkisë Përmet do të përfitojë një investim shumë interesant dhe të

rëndësishëm për sa i përket rinovimit dhe përgatitjes teknike të sallës së këshillit bashkiak, për të realizuar transmetimin *live* të mbledhjeve të këshillit me publikun apo me të interesuarit, për të plotësuar të gjitha kushtet teknike. Ajo është një sallë, e cila ka 100 vjet që është ashtu. Ju nuk e dini, por unë që e ndjek e di që është thjesht një sallë me katër mure dhe falë këtij projekti do të kthehet në një sallë të pajisur me të gjitha elementet teknike, teknologjike, me pajisje edhe për transmetim të drejtpërdrejtë dhe është një mënyrë shumë konkrete dhe direkte, që rrit, aq më tepër në kushtet e sotme të teknologjisë, transparencën mbi aktivitetin e këshillit bashkiak, duke i dhënë mundësi çdo qytetari apo çdokujt tjetër që është i interesuar, të ndjekë aktivitetin e këshillit bashkiak dhe më tej zbatimin e vendimeve të këtij këshilli. Kjo ishte thjesht për të dhënë një shembull të vogël se si mund të përfitohet përmes këtyre projekteve. Sigurisht, merita është e Bashkisë së Përmetit dhe e projektit. Në dijeninë time, duhet të jetë nënshkruar edhe marrëveshja me Bashkinë e Përmetit.

Ramazan Gjuzi – Ju faleminderit, zonja Kumbaro!

A ka pyetje të tjera?

Fjala për ju, zoti Xoxa, për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Jeton Xoxa – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me pyetjen e parë, për zyrat e statistikës në bashki, kjo do të jetë pjesë e projektit, por në marrëveshje është parashikuar një komision ndërministror dhe nëse për implementimin e projektit do të shikohet e nevojshme që të propozohen dhe iniciativa të tjera ligjore për zbatimin e këtij qëllimi, do të propozohen edhe iniciativa ligjore, pasi ky komitet drejtues është i përbërë nga ministritë e linjës dhe nga vetë përfaqësuesit e projektit. Pra, do të jetë pjesë e shqyrtimit të këtij komiteti.

Për sa i përket pyetjes së zonjës Dhimitri, në fakt, unë e mora shënim dhe mund t'ju përgjigjemi me shkrim, pasi unë, si strukturë, mbuloj pjesën procedurale të marrëveshjes dhe duhet të konsultohem me përfaqësuesit e drejtorisë së pushtetit vendor për këtë çështje.

Ramazan Gjuzi – Ju faleminderit, zoti Xoxa!

Ka një sqarim relatori për pyetjen e zonjës Dhimitri.

Fadil Nasufi – Për sa i përket pyetjes së zonjës Dhimitri, edhe në relacion shpjegohet, por edhe në realitet e thamë që ndryshimet ligjore për fuqizimin e qeverisjes vendore në ligjin pas vitit 2015 janë shoqëruar edhe me organizmin e agjencive rajonale, që janë në sinkron dhe në përputhje ligjore të politikave kombëtare, që mbikëqyrin dhe bashkëpunojnë për funksione të përbashkëta

apo për kompetenca të deleguara, siç janë arsimi, shëndetësia, shërbimi pyjor, zjarrfikëset, ashtu siç është fuqizuar dhe ligji i prefektit, që ndjek problemet e pushtetit vendor me kompetenca shumë të qarta në ligjin përkatës. Kështu që gjithçka është e sinkronizuar dhe në harmoni, duke ruajtur decentralizimin, autonominë vendore dhe bashkërendimin ndërinstitucional.

Ramazan Gjuzi – Ju faleminderit, zoti Nasufi!

Të nderuar deputetë, duke ju falënderuar për pyetjet dhe diskutimet e bëra, e hedhim në votim në parim projektligjin! Kush është dakord? Kundër?

Miratohet.

Erion Piciri – Zoti kryetar, doja të bëja edhe unë një koment.

Ramazan Gjuzi – Tani e mbylla unë.

Erion Piciri – Pse, mbaroi ora?

Ramazan Gjuzi – Nuk mbaroi ora, por ky është një projektligj për marrëveshje, nuk është në dorën tonë. Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Erion Piciri – Ne vetëm opinione kemi, se gjë tjetër nuk kemi në dorë.

Ramazan Gjuzi – Nuk ta kam ndërprerë ndonjëherë fjalën, por nuk të pashë.

Erion Piciri – Të falënderoj, por doja të nënvizoja vetëm 2-3 gjëra të vogla. Meqenëse e ke kohën e kufizuar, herën tjetër.

Ramazan Gjuzi – Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju urojmë suksese!

Mbledhjen tjetër do t'jua njoftojmë nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Erion Piciri – Zoti kryetar, të jap motivin e votës time, në bazë të Rregullores.

Ramazan Gjuzi – Po, zoti Piciri.

Erion Piciri – Kam dy-tri fjalë në lidhje me këtë marrëveshje që po kalon, se është e rëndësishme për shpërqendrimin e pushtetit vendor. Unë e lexova me vëmendje shtojcën e marrëveshjes dhe këtu ka disa direktiva për klasën politike, për qeverinë, për maxhorancën, ku

thuhet: “Këshillat ende nuk ushtrojnë funksionet e tyre. Administrata bashkiake ende rekrutohet në bazë të bindjeve politike. Agjencitë rajonale të shpërqendruara kanë kapacitete të dobëta dhe kandidatët e partive të centralizuara nuk ndihmojnë në këtë koncept të bashkive të forta dhe të shpërqendrimit të pushtetit”. Unë jam pro në parim, por në shtojcën e marrëveshjes ka disa direktiva të qarta politike për klasën tonë politike dhe një ndër to kishte të bënte edhe me listat e hapura.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Ju faleminderit, zoti Piciri!

Mbledhjen tjetër do t’jua njoftojmë nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Mbledhja mbyllet këtu.

Ditën e mirë!

Kalofshi një pasdite të këndshme!

MBYLLET MBLEDHJA